



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Burime turistike dhe konceptimi i itinerareve kulturore

Ngarkesa: 4 kredite, 40 orë mësimore: 20 leksione / 20 seminare
Viti / Semestri: Viti I , semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Master i shkencave në “Komunikim Ndërkulturor dhe turistik trigjuhësh”
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (Nenet 4, 5, 6, 7)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Të pajisë studentët me njohuri të thelluara për trashëgiminë materiale dhe jomateriale, duke përfshirë aspektet e saj historike, natyrore, kulturore dhe etnografike. Të zhvillojë një qasje multidisiplinare për kuptimin dhe interpretimin e zhvillimit të territorit nëpërmjet gjuhës, komunikimit dhe dijes ndërdisiplinore. Të njohë studentët me iniciativat dhe instrumentet ndërkombëtare për promovimin e trashëgimisë, si itineraret kulturore të Këshillit të Evropës dhe mundësitë e zbatimit të tyre në Shqipëri.

Objektiva specifike lëndore:

1. Të analizojnë dhe interpretojnë forma të ndryshme të trashëgimisë kulturore dhe natyrore në një kontekst lokal dhe ndërkombëtar.
2. Të identifikojnë dhe zbatojnë instrumente të komunikimit dhe gjuhës në shërbim të promovimit dhe zhvillimit të territoreve me potencial turistik dhe kulturor.
3. Të aftësohen për të hartuar projekte kulturore dhe për të marrë pjesë në iniciativa ndërkombëtare mbi trashëgiminë, përmes punës praktike në terren dhe përvojës me aktorë të fushës.

Rezultatet e pritshme:

Kjo lëndë synon të zhvillojë te studentët:

1. Njohuri dhe të kuptuarit e bazave të trashëgimisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm të territoreve të vendit;
2. Analizën dhe sintetizimin e çështjeve që lidhen me trashëgiminë si një vektor i zhvillimit territorial (të identifikojnë asetet e trashëgimisë për t'i vënë ato në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm të territoreve dhe të përcaktojnë strategjitë e valorizimit);
3. Zotërimin e mjeteve (edhe digjitale) gjuhësore dhe teknikave të komunikimit që bëjnë të mundur analizimin e shkallës së njohjes së territoreve, teknikave të përmirësimit të komunikimit dhe transferimin e trashëgimisë;
4. Zotërimin e mjeteve gjuhësore dhe teknikave të komunikimit që bëjnë të mundur zhvillimin e itinerareve kulturore në vend;